



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 321/4 Prot.

Tiranë, më 26 / 04 / 2021

V E N D I M

Nr. 69, Datë 26 / 04 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 13, datë 17.02.2021, të D.Sh kundër Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se është martuar dy herë. Nga martesat e parë ka dy vajza të cilat janë në moshë madhore, ndërsa nga martesat e dytë nuk ka fëmijë por ka gjetur dy fëmijë, djalë dhe vajzë. Ankuesja informon se me fillimin e pandemisë është pa të ardhura, dhe të ardhurat e vetme sigurohen nga bashkëshorti i cili merr një pagë prej 30.000¹ lekësh dhe jetojnë me qira. Ankuesja deklaroi se është drejtuar tek zyrat e Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, për përfitimin e ndihmës ekonomike, por i janë përgjigjur se nuk i takon, pasi duhet ta ndihmojë djali i bashkëshortit që është në emigracion.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe të përfitojë ndihmën ekonomike.

¹ Referuar Vërtetimit datë 10.02.2021 të lëshuar nga Shoqëria e Ndërtimit “Kon.....”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 321/1, datë 25.02.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Drejtorinë e Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 1726/1, datë 11.03.2021, Drejtoria e Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “D.Sh, në momentin e paraqitjes për aplikim të Ndhmës Ekonomike pranë Njësisë Administrative nr. 2, gjatë intervistës (aplikimit), ka pohuar se pjesëtarë të familjes së saj, ndodhen jashtë shtetit. Bazuar në Ligjin 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, germa (a) përjashtohen nga ndihma ekonomike, shtetasit shqipëtarë, që banojnë jashtë shtetit, si emigrantë. Gjithashtu, bazuar dhe në nenin 15, germa (e), përjashtohen nga ndihma ekonomike familjet që kanë anëtarë në moshë pune, të aftë për punë, që nuk rezultojnë si punëkërkuar të papunë, pranë zyrave të punës, apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve. Pra, këto janë arsytet ligjore të mospërfitimit të Ndhmës Ekonomike, nga ana e familjes së D.Sh”.

Në vijim të shqyrtimit të çështjes, D.Sh në datë 16.04.2021, është paraqitur pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit, Korçë, është njohur me përgjigjen e kthyer nga Drejtoria e Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, dhe ka rënë dakord me përmbajtjen e shkresës².

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankueses për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për trajtimin me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike dhe familjare.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Në nenin 11/a të këtij ligji përcaktohet se: “*Personat jopërfitues. Nga ky ligj nuk përfitojnë: a) shtetasit shqiptarë, që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të përfituesve sipas pikës 1 të nenit 9, të këtij ligji*”, ndërsa në nenin 15, pika e) përcaktohet se: “*Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme: e) kanë anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/përdorim dhe banojnë në fshat*”.

Procedura dhe dokumentacioni i përfitimit të ndihmës ekonomike rregullohet sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e

² Referuar procesverbalit datë 16.04.2021, të mbajtur mes specialistes së Komisionerit dhe subjektit ankues.

kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Në pikën 2 të Kreut të I, përcaktohet se: “Përfituesit e ndihmës ekonomike janë: a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme; etj”, ndërsa në pikën 4 të këtij Kreu parashikohet se: “Për të përfitur ndihmë ekonomike, subjektet e përcaktuara në pikën 2, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: 4.1. Për familjet në nevojë, kryetari i familjes/njëri nga anëtarët madhorë, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kërkojnë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin, duke paraqitur, si më poshtë vijon:”.

Në këtë kuptim, referuar legjislacionit të sipërcituar, familjet të cilët kërkojnë të përfitojnë ndihmën ekonomike, duhet të aplikojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, pranë administratorit shoqëror të njësisë administrative.

Referuar Certifikatës familjare të ankueses, nr. 000942201, datë 16.02.2021 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë Korçë, provohet se familja e ankueses përbëhet nga gjashtë persona, nga dy bashkëshortët, tre fëmijë në moshë madhore dhe nipi.

Referuar provave dhe informacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se ankuesja ka aplikuar për të përfitur ndihmë ekonomike por nuk i plotëson kushtet për të përfitur sipas legjislacionit të sipërcituar, pasi ka një nga fëmijët i cili është në emigracion dhe ka bashkëshortin të punësuar.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, vlerësojmë se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë.

Neni 7 i LMD-së³, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, lidhur me trajtimin e rastit të shtetas D.Sh. Në mungesë të trajtimit të pabarabartë,

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetases D.Sh nga ana e Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike dhe familjare.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA